



# NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NËXTITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFLJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#91

## Ministri i Shtetit për Diasporën dhe IOM bashkëpunim në projektet për Diasporën



Ministri i Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko dhe Drejtuesja e Zyrës së IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin) në Shqipëri znj. Alma Jani kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi me interesa të përbashkëta për sa i përket promovimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve shqiptare që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe vendeve pritëse.

Sipas kësaj marrëveshjeje, të dy palët mund të vendosin të veprojnë bashkërisht në zbatimin e projekteve me institucionet e Ministrisë së Diasporës: Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, Qendrën e Botimeve të Diasporës dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët që janë me interes të përbashkët.

Gjithashtu, të dyja palët mund të krijojnë komisione, komitete ose organe të tjera teknike ose këshilluese, për t'i këshilluar ata për çështje me interes të përbashkët.



## Vota e Diasporës Shqiptare

Të interesuarit për të drejtën e votës në migracion mund të marrin më shumë informacion në faqen e Web-it të Komisionit të Reformës Zgjedhore.

## KQZ nis procedurat për votimin jashtë vendit: Si mund të bëhet votimi

Zgjedhjet e 25 prillit 2021 do të jenë historike në vendin tonë, pasi për herë të parë pritet të aplikohet votimi për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Për këtë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nisur lëvizjet e saj, teksa së fundmi i ka dërguar një letër Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Përmes saj, KQZ i kërkon numër të saktë të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Grupi i punës i ngritur pranë KQZ-së ka paraqitur pjesën e parë të raportit, për të vlerësuar mundësinë dhe eventualisht procedurat për realizimin e votimit jashtë vendit të shtetasve shqiptar me të drejtë vote e me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.




## Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës

është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

[rrjetiprofesionisteve.al](http://rrjetiprofesionisteve.al)

## VENDIMI/ Këshilli Koordinues i Arsimitarëve në Diasporë, ja anëtarët sipas shteteve



Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën ka propozuar listën e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Arsimitarëve në Diasporë e cila është miratuar edhe nga ministri i Shtetit për Diasporën. Ky këshill që vepron pranë Qendrës së Botimeve për Diasporën bëri propozimet nga radhët e arsimtarëve shqiptarë në Diasporë, bazuar në eksperiencën në fushën e mësimdhënies, veprimtarinë që kanë zhvilluar në Diasporë dhe kontributin e tyre.

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Arsimitarëve të Diasporës janë: Vaxhid Sejdiu (Zvicër), Mira Hasa Shehu (Kanada), Teuta Tabaku (Turqi), AurelaKonduri(Greqi), Anila Kadia (Mbretëri e Bashkuar), Armenda Amiti (Slloveni), Dritan Mashi (Itali), Isuf Bytyçi (Gjermani), Melita Oreshkoviç (Kroaci), Michele Greco (Itali), Mimoza Dako (Zvicër), Miradie Berisha (Austri), Mustafë Krasniqi (Gjermani), Musa Pali (Zvicër) dhe Qemal Zylo (SHBA).




Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

## Arbëreshët/ QSPA, konsultë akademike për botimet në 2021-shin

Metodologjia e përzgjedhjes së veprave që mund të aplikohen në vitin 2021 dhe strategjitë në plane afatgjata e afatshkurtra kanë qenë temë e mbledhjes së parë për këtë vit i Këshillit Koordinues të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Në mbledhje ishin të pranishëm e anëtarët e Këshillit Koordinues dhe anëtarët e Këshillit Akademik Teknik mbi Botimet, së bashku me Ministrin e Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko dhe Drejtoreshën Ekzekutive të QSPA Diana Kastrati.

Më herët, QSPA ka zhvilluar një konsultë akademike me profesorë për të diskutuar nevojat prioritare të botimeve mbi dhe nga arbëreshët.



## Digitalizimi i Veprave Shqiptare

Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen

[adld.al](http://adld.al)

## LIBRI I RI/ Botohet shqip-greqisht "Ushtari prej Plumbi" dhe "Borëbardha"



Qendra e Botimeve për Diasporën ka publikuar në faqen online të saj botimin e radhës të kolanës klasikët dy gjuhësh, përrallat në shqip dhe greqisht "Ushtari prej Plumbi" dhe "Borëbardha".

"Ushtari prej Plumbi" shkruar nga autori Peter Holeinone, është historia e një ushtari prej plumbi, i cili megjithëse ishte derdhur në metal si shokët e tij, tregoi se kishte një zemër të ndjeshme. Fundi i tij dhe balerinës, ndryshon aq shumë nga përrallat e tjera.

"Borëbardha", përralla më e famshme e Vëllezërve Grimm në të gjithë botën, vjen për lexuesit e vegjël në këtë libër në shqip dhe në greqisht.

## Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store: [këtu](#) Play store: [këtu](#)